

Plotësimi i Fletë - Inventarit për gjendjen e mallrave dhe materialeve të blera me TVSH, për biznesin e vogël

Tatimpaguesit e biznesit të vogël me xhiro mbi 2 000 000 lek deri në 5 000 000 lekë, të cilët bazuar në ligjin nr.107/2017 – Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, VKM nr.953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave "Për Dispozitat Zbatuese të ligjit nr.92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", neni 11, duke nisur nga data 1 Prill 2018, do të përfshihen në skemën e TVSH-së, duhet që krahas masave organizative që duhet të ndërmerren, do të raportojnë edhe inventarin e gjendjes stok të mallrave deri në datën 31 Mars 2018, të blerë me faturë me TVSH jo më parë se 12 muaj.

Për këtë arsye, duhet të mbahet parasysh sa më poshtë:

- Të përpilohet lista e mallrave stok të specifikuar në sasi dhe në vlerë, ku të evidentohet data e regjistrimit të stokeve, sipas formularit bashkëngjitur këtij njoftimi;
- Çdo mall i përfshirë në inventar, duhet të jetë i justifikuar me faturë tatimore të blerjes me TVSH, i blerë jo më parë se 12 muaj nga data e deklarimit të inventarit, dhe të jenë të regjistruara në librat e tatimpaguesit. Periudha e faturave të deklaruara në inventar është [data 01 Prill 2017 deri në 31 Mars 2018](#).
- Inventari, duhet të dorëzohet në drejtorinë rajonale, në momentin e regjistrimit në regjimin normal të TVSH-së, brenda [datës 30 Prill 2018](#). Një kopje të këtij inventari tatimpaguesi e ngarkon edhe në e-filing.

Fiskalizimi

Çdo tatimpagues i regjistruar në TVSH për herë të parë duhet:

-Të komunikojë me shoqërinë e autorizuar që e ka furnizuar me pajisjen fiskale për të bërë ndryshimin e shkallës tatimore të TVSH-së, me qëllim, lëshimin nga data 1 prill 2018, të kuponit tatimor me TVSH.

-Të pajisjet pranë drejtorisë rajonale tatimore ku është i regjistruar me blloqet e faturave tatimore me TVSH, që lëshohen për transaksione me vlera mbi 40,00 lekë ose kur blerësi kërkon vetë një faturë tatimore prej shitësit.

